

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga COFORGE LIMITED, me seli të regjistruar në Parcelën nr. 13, Udyog Vihar, Faza-IV, Sektori-18, Palam Road, Gurugram, Haryana, Indi 122015, përmes Dejan Knezoviqit, avokat nga Shoqëria e Avokatëve Knezoviq dhe Bashkëpunëtorët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 18.02.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin COFORGE LIMITED, me seli të regjistruar në Parcelën nr. 13, Udyog Vihar, Faza-IV, Sektori-18, Palam Road, Gurugram, Haryana, Indi 122015, do të fitojë kontrollin mbi ENCOR A USA HOLDCO, INC, me seli të regjistruar në C/O Corporation Trust Center, rruga Orange nr. 1209, Wilmington, New Castle, Delaware 19801, SHBA dhe ENCOR A HOLDINGS LIMITED, me seli të regjistruar në C/O Maples Corporate Services Limited, kutia postare 309, Uglan d House, South Church Street, George Town, Grand Cayman, KY1-1104, Ishujt Kajman, përmes shitblerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 29.01.2026, dhe plotësuar më 03.02.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga COFORGE LIMITED, me seli të regjistruar në Parcelën nr. 13, Udyog Vihar, Faza-IV, Sektori-18, Palam Road, Gurugram, Haryana, Indi 122015, me të cilin do të fitojë kontrollin mbi ENCOR A USA HOLDCO, INC, me seli të regjistruar në C/O Corporation Trust Center, rruga Orange nr. 1209, Wilmington, New Castle, Delaware 19801, SHBA dhe ENCOR A HOLDINGS LIMITED, me seli të regjistruar në C/O Maples Corporate Services Limited, kutia postare 309, Uglan d House, South Church Street, George Town, Grand Cayman, KY1-1104, Ishujt Kajman.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të tij, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

COFORGE LIMITED është një shoqëri aksionare dhe ofrues global i shërbimeve dhe zgjidhjeve teknologjike, i cili përdor teknologjitë e reja dhe ekspertizën e thellë në këtë fushë për të siguruar ndikim mbi botën reale të biznesit për klientët e tij. Fokusimi në industri të përzgjedhura, kuptimi i thellë i proceseve bazë të atyre industrive dhe partneritetet me platformat kryesore teknologjike, i mundësojnë Coforge të jetë partner i besueshëm i klientëve të tij në iniciativat e tyre të transformimit. Coforge është lider me qasjen e tij drejt inxhinierisë së produkteve dhe përdor teknologjitë e inteligjencës artificiale, cloud, të dhënat, integrimin dhe automatizimin për të transformuar bizneset në ndërmarrje inteligjente me rritje të lartë.

COFORGE LIMITED nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut dhe nuk realizon asnjë qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

ENCORA USA HOLDCO, INC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ENCORA HOLDINGS LIMITED, Ishujt Kajman, janë pjesë e Grupit ENCORA.

Grupi ENCORA është një grup për shërbime teknologjike i themeluar me një model operativ të bazuar në inteligjencën artificiale, i cili ofron shërbime inxhinierike për ndërmarrjet nga lista “Fortune 1000” dhe për kompanitë digjitale.

Grupi ENCORA aktualisht ka një shoqëri të lidhur të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëria për shërbime të teknologjisë së informacionit ENCORA MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën “Filipi i Dytë i Maqedonisë” nr. 3, Soravia Center, kati i 2-të, Shkup, NUAS 7533489 dhe me veprimtari prioritare 62.100 – programim kompjuterik.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ